

**UDHEZIM I PERBASHKET**  
(Nr 6, date 09.10.2007)

**PER**  
**MBLEDHJEN DHE RUAJTJEN E TE DHENAVE PER CILESINE E**  
**BENZINES DHE TE DIEZELIT**

Ne zbatim nenit 102 te Kushtetutes, te pikes 7 te VKM nr. 147, date 21.03.2007 “Per cilesine e lendeve djegese, benzine dhe diezel”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes,

**UDHEZOJNE:**

1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, bashkeveprojne dhe bashkerendojne veprimtarine nepermjet strukturave te specializuara te tyre per mbledhjen dhe ruajtjen e te dhenave per cilesine e lendeve djegese, benzine dhe diezel sipas standarteve dhe afateve kohore te percaktuara ne VKM nr.147, date 21.03.2007 “Per cilesine e lendeve djeges benzine dhe diezel“.
2. Inspektoriati Qendror Teknik, merr dhe sistemon te dhenat nga prodhuesit vendas, nga Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave dhe tregtuesit me shumice dhe pakice ne lidhje me cilesine dhe sasine e lendeve djegese benzine dhe diezel per shkallen e perputhshmerise per secilin parameter. Nje kopje e ketyre te dhenave dergohet prane Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve cdo 6 muaj qe nga dita e hyrje ne fuqi te ketij udhezimi.
3. Strukturat lokale te Inspektoriarti Qendror Teknik organizojne ne bashkepunim me Agjencite Rajonale te Mjedisit programe pune te perbashketa per marrjen e mostrave per cilesine e lendeve djegese benzine dhe diezel.
4. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes organizojne 2 here ne vit takime te perbashketa te strukturave te tyre te ngarkuara per zbatimin e ketij udhezimi per shkembimin e informacionit mbi ecurine e zbatimit te VKM nr 147, adte 21.03.2007 “Per cilesine e lendeve djeges benzine dhe diezel”.
5. Te dhenat e grumbulluara, per parametrat e lendeve djeges, benzine dhe diezel, analizohen nga Inspektorati Qendror Teknik dhe jane objekt i diskutimit ne takimet e perbashketa midis Ministris se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave sipas pikes 4 te ketij Udhezimi.

6. Rafinerite dhe shoqerite e tregtimit me shumice dergojne prane Inspektoriatit Qendror Teknik, cdo tre muaj, informacion ne lidhje me sasite e lendeve djegese benzine dhe diezel te hedhur ne tregun e brendshem.
7. Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve ruan dhe administron informacionin e marre nga Inspektorati Qendror Teknik dhe krijon databaze te te dhenave ne lidhje me cilesine e benzines dhe diezelit. Nje kopje e informacionit publikohet ne faqen elektronike te Ministrise se Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.
8. Ngarkohen Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve dhe Inspektoriati Qendror Teknik per zbatimin e ketij Udhezimi.

Ky udhezim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe  
Administrimit te Ujerave**

**Ministri i Ekonomise  
Tregtise dhe Energjitikes**

**Lufter XHUVELI**

**Genc RULI**